



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:067350

Datë: 07.12.2020

Numri i dokumentit: 01323887

A.nr.1023/2020

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ të paditësit N.T.H. [“G...”] nga Komuna e Deqanit kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, jashtë seancës me dt. 07.12.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET poshtë si e parakohshme padia e paditësit N.T.H. [“G...”] nga Komuna e Deqanit të ushtruar ndaj Aktvendimit datës 26.02.2019 i Doganës së Kosovës-Drejtoria Rajonale-ZBD Pejë

A R S Y E T I M

Paditësi N.T.H. [“G...”] nga Komuna e Deqanit, me padin e datës 12.06.2020, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditures Dogana e Kosovës në Prishtinë-Drejtoria Rajonale Pejë. Në parashitë paditësi pretendon se ka marr një aktvendim nga Dogana e Kosovës në Pejë me datën 23.04.2020, ku në këtë aktvendim më është cekur afati 30 ditë për të ushtruar ankes në Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve pranë Doganës së Kosovës në Prishtinë. Për shkak të pandemis nuk kam mundur të bëj ankesën prej 30 ditësh për shkak të izolimit në shtëpi.

Gjykata pasi ka shqyrtuar lejueshmërinë e kërkesëpadisë të paditësit kundër aktvendimit datës 26.02.2019, ka konstatuar se padia e paditësit është e parakohshme.

Nga shkresat e lëndës, gjykata nuk ka gjetur se ekziston akti administrativ i Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës, vendimi i të cilit është përfundimtar në procedurën administrative. Gjithashtu paditësi nuk ka prezantuar para gjykatës se pas marrjes së aktvendimit datës 26.02.2019 nga Drejtoria Rajonale-ZBD Pejë, ka ushtruar ankes në Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve të Doganës së Kosovës, ashtu siq është dhënë Këshilla juridike në aktvendimin e datës 26.02.2019, pra nuk ka prova se paditësi i ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, për të ngrit konflikt administrativ në gjykat.

Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 291 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, parashihet që: 1. Çdo person ka të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të sjellë nga Dogana e, i cili ka të bëjë me aplikim e legjislacionit doganor, i cili ka të bëjë me atë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. 2. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit ushtrohet pranë Doganës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore, paditësi është dashur ti shteroj mjetet e brendshme juridike, ashtu që pas pranimit të Aktvendimit dt.26.02.2019 i Drejtoris Rajonale ZBD Pejë, ti drejtohet me ankes Sektorit për rishqyrtimin e vendimeve-Dogana e Kosovës.

Vendimi i Sektorit për rishqyrtimin e vendimeve-Dogana e Kosovës, është vendim përfundimtar në procedurën administrative, ndaj të cilit paditësi ka të drejt të paraqes padi në Gjykat, procedurë kjo që e ka rregulluar dispozita e nenit 3 par.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK dhe Procedurat nr.03/L-222.

Gjykata nuk ka mundur të pranoj pretendimet e paditësit për ta pranuar si të rregullt padin, pasi që në rastin konkret nuk kemi një vendim të Sektorit për rishqyrtimin e vendimeve-Dogana e Kosovës, dhe nuk ka prova se paditësi i është drejtuar këtij Sektori për të vepruar sipas ankesës. Padia është paraqitur si e parakohshme.

Në bazë të arsyeve të lartcekura, e në kuptim të dispozitave te nenit 81.C të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 34 par.1.1 të Ligjit per Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1023/2020 dt.07.12.2020

G j y q t a r i ,
Krenar Berisha

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykat